



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë Ligjore të Ministrive, Komunave dhe
Ndërmarrjeve publike (PTK & KEK)

Janar-Mars, 2012



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë Ligjore të Ministrive, Komunave dhe
Ndërmarrjeve publike (PTK & KEK)

Janar-Mars, 2011

**Programi për Qeverisje të Mirë, financohet nga Zyra Zvicerane për
Bashkëpunim në Kosovë**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)". Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

Projekti "Mbwshtetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike" financohet nga:



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga OSI/CRD. Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e OSI/CRD.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Shkeljet nga ana e ministrive	4
Ministria e Punëve të Brendshme	4
Ministria e Infrastrukturës	4
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	5
Ministria për Komunitete dhe Kthim	6
Shkeljet nga Ndërmarrjet Publike	7
Korporata Energjetike e e Kosovës	7
Postë Telekomunikacioni i Kosovës	8
Shkeljet nga ana e Komunave	8
Komuna e Prizrenit	8
Komuna e Gjilanit	9
Komuna e Pejës	9
Raportimet e Gazetave Ditore në Fushën e Prokurimit Publik	10
Rekomandimet	11
Falënderim	12
Lëvizja FOL	12

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
BE	Bashkimi Evropian
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KK	Komisioni i Konkurrencës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MI	Ministria e Infrastrukturës
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
OE	Operator Ekonomik
OSI	Open Society Institute
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSH	Paneli Shqyrtues (Organ i OSHP-së)
RPP	Rregullorja e Prokurimit Publik

Përmbledhje Ekzekutive

Ministritë, Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) dhe Komunat e Republikës së Kosovës kanë vazhduar avazin e vjetër të shkeljeve dhe parregullsive ligjore në fushën e prokurimit publik. Përgjatë periudhës tremujore, janar-mars 2012, këto institucione kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 11 tenderë të ndryshëm. Prej tyre 8 janë kthyer në ri-vlerësim nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, 2 janë kthyer në ri-tenderim dhe vetëm në 1 aktivitet prokurimi është marrë vendimi për vazhdim të aktivitetit të prokurimit.

Prej tyre ministritë kanë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në gjithsej 4 tenderë të ndryshëm: a) Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e tenderit “Furnizim me karburante”; b) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të”; c) Ministria për Komunitete dhe Kthim në tenderin “Shërbime hoteliere në ndërtesën e MKK-së”; dhe d) Ministria e Infrastrukturës me rastin e vlerësimit të tenderit “Shërbimet e mirëmbajtjes së seksionit 1 deri në 5 të rrugës nr. 7: Autostrada Morinë-Merdare”. Përveç kësaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka shqiptuar edhe një gjobë ndaj Ministrisë së Infrastrukturës në vlerë prej 10,000.00 eurove, si dhe ka revokuar licencën e ushtruesit të drejtorit të kësaj ministrie për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e prokurimit publik.

Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) kanë bërë shkelje ligjore në katër (4) tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore në tre (3) tenderë të ndryshëm: a) shërbime ndihmëse në largimin e djerrinës (sipas nevojës); b) “furnizim me kemikale” dhe c) “Furnizim me shirit gome”. Ndërkaq Postë-Telekomi i Kosovës në vetëm një tender: “Benefite për sigurim shëndetësor”. Të katër tenderët e këtyre ndërmarrjeve janë kthyer në ri-vlerësim.

Komunat kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej tre tenderë të ndryshëm. Komuna e Prizrenit ka shkelur dispozitat ligjore me rastin e vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, trotuareve, hapësirave të gjelbëruara publike, shesheve dhe drunjve dekorativë në Prizren dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve nëpër fshatra-zona”; Komuna e Gjilanit me rastin e anulimit të tenderit “Transporti i punëtorëve dhe nxënësve të KK Gjilan, ndarja në 7 Lote” dhe Komuna e Pejës me rastin e vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja e shenjave të komunikacionit - Lot 1”. Prej këtyre tenderëve dy janë kthyer në ri-vlerësim, ndërkaq vetëm njëri është anuluar nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Raportimet e gazetave ditore¹ në fushën e prokurimit publik përbëjnë një rëndësi të jashtëzakonshme në eliminimin e parregullsive ligjore dhe praktikave korruptive në kuadër të kësaj fushe. Përgjatë periudhës tremujore gazetave ditore kanë publikuar gjithsej 69 artikuj të ndryshëm. Prej tyre 24 shkrime kanë qenë në gazetën Zëri; 22 në Koha Ditore, 15 sosh në gazetën Express dhe 8 shkrime në Kosova Sot. Prej këtyre 69 artikujve gazetaresk 34 kanë qenë raportime hulumtuese, ndërkaq 35 sosh kanë qenë të publikuara në formën e lajmeve.

¹ Në kuadër të hulumtimit tonë kemi zgjedhur vetëm katër gazetave kryesore ditore në Kosovë: Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe gazeta Express.

Shkeljet nga ana e Ministrive

Ministritë kanë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në gjithsej 4 tenderë të ndryshëm: a) Ministria e Punëve të Brendshme me rastin e tenderit “Furnizim me karburante”; b) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të”; c) Ministria për Komunitete dhe Kthim në tenderin “Shërbime hoteliere në ndërtesën e MKK-së”; dhe d) Ministria e Infrastrukturës me rastin e vlerësimit të tenderit “Shërbimet e mirëmbajtjes së seksionit 1 deri në 5 të rrugës nr. 7: Autostrada Morinë-Merdare”. Përveç kësaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka shqiptuar edhe një gjobë ndaj Ministrisë së Infrastrukturës në vlerë prej 10,000.00 eurove, si dhe ka revokuar licencën e ushtruesit të drejtorit të kësaj ministrie për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e prokurimit publik.

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë shkelje ligjore në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me karburante”. Fillimisht, kompania “HIB Petrol” është ankuar tek Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik për parregullsi të shumta që e kanë shoqëruar një tender të tillë. Kjo kompani është ankuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, duke qenë se operatori i propozuar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar licencën përkatëse nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe nuk ka poseduar marrëveshjen e konsorciumit apo grupit me ndonjë OE tjetër.² Më pastaj, OSHP-ja e ka caktuar ekspertin shqyrtues, i cili në raportin e tij nuk ka konstatuar ndonjë shkelje gjatë procesit të vlerësimit të ofertave - siç ka pretenduar kompania ankuese. Megjithatë, duke qenë se kompania ankuese ka refuzuar vlerësimin e ekspertit, është mbajtur edhe seanca dëgjimore nga ana e Panelit Shqyrtues. Në këtë seancë kompania “HIB Petrol” ka shtruar listën e kushteve dhe specifikacioneve që nuk janë përmbushur nga kompania “Bajraktari”, e rekomanduar për dhënie të kontratës. Sipas kësaj pale ankimore “Bajraktari” nuk ka poseduar deklaratën nën betim, certifikatën e regjistrimit të biznesit, certifikatën e regjistrimit të TVSH-së, licencat e kërkuara në pikën G për tregtimin e derivateve me shumicë dhe pakicë dhe deponimin e derivateve të naftës. Duke parë shkeljet e tilla, Paneli Shqyrtues ka vendosur në favor të kompanisë ankuese, duke qenë se MPB ka shkelur nenin 59 të Ligjit për Prokurimit Publik. Me këtë rast, ky aktivitet i prokurimit është kthyer në **ri-tenderim**.

Ministria e Infrastrukturës

Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje në tenderin “Shërbimet e mirëmbajtjes së seksionit 1 deri në 5 të rrugës nr. 7: Autostrada Morinë-Merdare”, me Nr. të Prokurimit MI/11/067/211. Shkeljet e tilla janë evidentuar gjatë procesit të vlerësimit të ofertave

² Një kriter i tillë është kërkuar në nenin 4.2., pika g e dosjes së tenderit. Mirëpo, operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës “Bajraktari” ka ofruar kopjen e kontratës së qiramarrjes dhe licencën e kompanisë “Fitorja” nga Ferizaji.

të operatorëve ekonomikë që kanë ofruar për këtë tender. Duke parë parregullsitë ligjore të shkaktuara nga Komisioni Vlerësues, kompania “Victoria Invest International” - Suharekë (kryesuese e JV) & “Alb Shpresa”-Tiranë & “Ereniku”-Tiranë & “Victoria Invest”-Elbasan është ankuar tek Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik. Sipas të gjeturave të ekspertit vlerësues rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk respektuar nenin 7 dhe 69 të LPP-së, sepse në rastin e hartimit të Dosjes së Tenderit nuk ka lënë hapësirë për konkurrencë të operatorëve ekonomikë vendorë. Më tej, pas dëgjimit të provave në seancën dëgjimore të organizuar nga PSH, ky i fundit ka konstatuar se OE ankues është shpallur pa të drejtë i papërgjegjshëm, duke qenë se i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues. Me këtë rast OSHP-ja ka marrë vendimin e saj që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**.

Gjatë kësaj kohe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka marrë vendim për anulimin e licencës së prokurimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit të departamentit të prokurimit, Bekim Gojanit. Po ashtu, me këtë rast OSHP-ja ka shqiptuar edhe një gjobë në vlerën e 10,000.00 eurove për moszbatim të vendimeve në lidhje me këto aktivitete të prokurimit:

- Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët magjistrale dhe rajonale të Kosovës për vitin 2011, pjesa 1, pjesa 2, pjesa 4, pjesa 5, pjesa 6, pjesa 7 dhe pjesa 8;
- Sanimi i rrugës regjionale R-105, Segmenti Klinë-Brojë, L=4.0 KM;\
- Ndërtimi i rrugës - Kuqishtë-Bogë;
- Furnizim me kripë industriale për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës për sezonin dimëror 2011/2012;
- Transportin humanitar të udhëtarëve; dhe
- Sigurimi i automjeteve dhe sigurimi shëndetësor i udhëtimit jashtë vendit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

MKRS ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së me rastin e aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të”. Në këtë tender sipas palës ankimore “R&Rukolli” janë shkelur një sërë dispozitash ligjore, por shkelja më e madhe sipas saj ka ndodhur se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar si dëshmi Draft-Kontratën mbi sigurimin e vend-ndërtimit me një kompani të licencuar dhe të njohur të sigurimeve, ashtu siç është kërkuar në pikën 8 të kërkesave mbi përshtatshmërinë në Dosjen e Tenderit. Megjithëse me pretendimet e palës ankimore nuk është pajtuar eksperti shqyrtues i këtij aktiviteti të prokurimi, Paneli Shqyrtues ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-tenderim** pikërisht për shkakun se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “KAËA Group & BAMIRS” nuk ka ofruar dëshminë e Draft-Kontratës.


Ministria për Komunitete dhe Kthim

Me rastin e vlerësimit të tenderit “Shërbime hoteliere në ndërtesën e MKK-së” komisioni vlerësues i këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të shumta ligjore. Pasi që dy kompani pjesëmarrëse në këtë aktivitet prokurimi janë ankuar, “Global Parajsa” nga Vushtrria dhe “Luzern” nga Ferizaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka autorizuar ekspertin i cili në raportin e analitik të tij ka konstatuar parregullsi të shumta me rastin e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë:

- Lëshimi i parë ka të bëjë më periudhën e tenderimit, përkatësisht interpretimin jo të drejtë lidhur me kërkesën e Certifikatës për TVSH. Më konkretisht, njëri nga pjesëmarrësit në këtë tender, “C-Pictures”, me 13 shkurt të këtij viti ka parashtruar pyetjen lidhur me statusin e tij si tatimpagues karshi ATK-së, ku sqaron se ende nuk është deklarues i TVSH-së dhe kërkon që Autoriteti t’ia sqarojë situatën sesi duhet të veprojë në këtë rast. Në ndërkohë, ajo ofron një deklaratë me shkrim se ajo ende nuk ka arritur qarkullimin për të qenë deklarues i TVSH-së. Ndërkaq, përgjigja e prerë e AK ka qenë se pa një dokument të tillë nuk mund të konkurrojë për fitimin e këtij tenderi. Eliminimi i këtij OE nga ky aktivitet prokurimi sipas ekspertit është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së.
- Lëshimi i dytë ka ndodhur me rastin e ekzaminimit të tenderit. Komisioni i Vlerësimit ka eliminuar 2 kompanitë ankuese për arsyen e njëjtë - “mosplotësim i rubrikës për Siguri të Ekzekutimit të kërkuar në Formularin e Tenderit”. Kjo sipas

palëve ankimore, ekspertit shqyrtues dhe OSHP-së nuk përbën shkelje ligjore, pasi që rubrikat kanë pasur të bëjnë vetëm ‘nacionalitetin dhe sigurinë e ekzekutimit’, e të cilat janë të dëshirueshme të plotësohen, por assesi të detyrueshme.

Duke parë shkeljet e tilla, Organi Shqyrtues i



Prokurimit Publik ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-vlerësim.

Shkeljet e Ndërmarrjeve Publike³

Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) kanë bërë shkelje ligjore në katër (4) tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore në tre (3) tenderë të ndryshëm: a) shërbime ndihmëse në largimin e djerrinës (sipas nevojës); b) “furnizim me kemikale” dhe c) “Furnizim me shirit gome”. Ndërkaq Postë-Telekomi i Kosovës në vetëm një tender: “Benefite për sigurim shëndetësor”. Të katër tenderët e këtyre ndërmarrjeve janë kthyer në ri-vlerësim.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) - ka bërë shkelje në tri aktivitete të prokurimit. Në tenderin e parë, “shërbime ndihmëse në largimin e djerrinës (sipas nevojës)”, AK ka shkelur dispozitat e nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik, i cili e specifikon se *“Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.⁴ Fillimisht, kompania nga Obiliqi “KOS STEEL” është ankuar tek Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, ndërkaq më pas ky i fundit e ka autorizuar ekspertin shqyrtues për ta analizuar lëndën e këtij tenderi. Bazuar në të gjeturat e tij, eksperti ka evidentuar një sërë parregullsish ligjore që KEK ka bërë me rastin e vlerësimit të ofertave nga operatorët ekonomikë:

- operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar dëshmi për sigurimin e tenderit dhe;
- anëtari i konsorciumit “Beni Com” nuk ka poseduar Deklaratën nën Betim, sic kërkohet me nenin 71, pika 4 e LPP-së.

Duke parë shkeljet e tilla të shkaktuara gjatë procesit të vlerësimit, Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka marrë vendim për kthimin e këtij në tenderi në **ri-vlerësim**. Mirëpo, Korporata Energjetike e Kosovës ka shpërfillur një vendim të tillë, duke mos bërë ri-vlerësimin e këtij tenderi, por duke e anuluar në tërësi atë. Kjo ka detyruar OSHP-në që të lëshojë një urdhëresë, ku specifikohet se AK duhet t’i përmbahet vendimit paraprak për ri-vlerësim të ofertave dhe në asnjë rrethanë ta anulojë këtë aktivitet prokurimi.

Në tenderin e dytë, “furnizim me kemikale”, KEK ka shpallur të papërgjegjshme OE “Ripten Engineering”, por që e cila i ka plotësuar kushtet dhe specifikacionet e kërkuara. Pasi kjo kompani është ankuar në OSHP, dhe pas shqyrtimit analitik nga ana e ekspertit të këtij aktiviteti, është konstatuar se Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje të nenit 7, nenit 51, nenit 65 dhe nenit 67 të LPP-së. Duke marrë parasysh se me raportin e ekspertit është pajtuar Autoriteti Kontraktues, OSHP-ja ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**.

³ Duke qenë se ekzistojnë shumë ndërmarrje publike, FOL monitoron vetëm dy ndërmarrjet kryesore në vend: KEK-un dhe PTK-në.

⁴ Me gjerësisht shih Ligjin për Prokurim Publik (Nr. 03/L-241), Kuvendi i Kosovës, fq. 63

Ndërkaq, në tenderin e tretë, “Furnizim me shirit gome”, Komisioni i Vlerësimit ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE “New KO Balkan”, e cila ka ofruar çmimin me të lartë për totalin e njësive. Ndërkaq, kompania “NTSH-Ekoinvest” me çmim të lirë për njësi, e cila edhe ka ushtruar ankesë tek OSHP-ja, nuk është rekomanduar fare për kontratë. Bazuar edhe në vlerësimet e ekspertit, por edhe në deklaratimet e palës ankimore dhe Autoritetit Kontraktues, PSH ka konstatuar se me rastin e rekomandimit për dhënie të kontratës janë shkelur dispozitat e nenit 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurim

Publik. Me këtë rast edhe ky tender është kthyer në ri-vlerësim.



Postë-Telekomi i Kosovës - ka bërë shkelje me rastin e tenderit “Benefite për sigurim shëndetësor”. Fillimisht, kompanitë “KS-Dardania” dhe “Sigal Uniqa Group Austria” janë ankuar për parregullsitë e shumta që e kanë shoqëruar procesin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Më pas, eksperti shqyrtues ka analizuar lëndën e këtij

aktiviteti dhe ka konstatuar se me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë shkeljen e nenit 59 të LPP-së, pasi paligjshëm dhe padrejtësisht ka eliminuar operatorin ekonomik “KS-Dardania”. Ndërkaq, eliminimi i OE “Sigal Uniqa Group Austria” nga ana e AK është vlerësuar se ka qenë i justifikueshëm, pasi ka ofertuar më dy çmime të ndryshme. Më pastaj, OSHP-ja ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-vlerësim.

Shkeljet nga ana e Komunave

Komunat kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej tre tenderë të ndryshëm. Komuna e Prizrenit ka shkelur dispozitat ligjore me rastin e vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, trotuareve, hapësirave të gjelbëruara publike, shesheve dhe drunjve dekorativë në Prizren dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve nëpër fshatra-zona”; Komuna e Gjilanit me rastin e anulimit të tenderit “Transporti i punëtorëve dhe nxënësve të KK Gjilan, ndarja në 7 Lote” dhe Komuna e Pejës me rastin e vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja e shenjave të komunikacionit - Lot 1”. Prej këtyre tenderëve dy janë kthyer në ri-vlerësim, ndërkaq vetëm njëri është anuluar nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Komuna e Prizrenit - ka bërë shkelje në aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, trotuareve, hapësirave të gjelbëruara publike, shesheve dhe drunjve dekorativë në Prizren dhe mirëmbajtja dimërore e rrugëve nëpër fshatra-zona”. Fillimisht, operatori ekonomik “IS Company SH.P.K” nga Prizreni është ankuar tek Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, me ç’rast ky i fundit ka autorizuar edhe ekspertin shqyrtues. Mbi bazën e të gjeturave të tij, eksperti ka gjykuar se Autoriteti Kontraktues

nuk ka respektuar nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik. i cili specifikon se duhet trajtim i barabartë në kontekst të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Me këtë rast OSHP-ja e ka kthyer këtë tender në **ri-vlerësim** dhe ka kërkuar nga Komuna e Prizrenit që t'i përmbahet kriterit për dhënie të kontratës “Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët”.



Komuna e Gjilanit - ka bërë shkelje me rastin e anulimit të tenderit “Transporti i punëtorëve dhe nxënësve të KK Gjilan, ndarja në 7 Lote”. Pasi ankesës së ushtruar nga ana e OE “Merkatori”, OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për ta analizuar në tërësi këtë aktivitet të prokurimit. Me këtë rast, eksperti ka konstatuar se gjatë procesit të vlerësimit

të ofertave Komisioni ka bërë shkelje të nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), nenit 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit) dhe nenit 109 (Afatet për Dorëzimin e Ankesës). Me mendimin e ekspertit është pajtuar Autoriteti Kontraktues, që **nuk do ta bëjë anulimin** e tenderit, por do ta ri-vlerësojë atë dhe do t'i përmbahet kriterit për dhënie të tenderit të përgjegjshëm me çmim më të ulët. dhe lënda do të kthehet në ri-vlerësim.

Komuna e Pejës - ka bërë shkelje të shumta me rastin vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja e shenjave të komunikacionit - Lot 1”. Në këtë aktivitet prokurimi Komuna e Pejës ka shkelur dispozitat ligjore me rastin e kërkesës së saj tek pjesa II e përshkrimit të çmimeve Lot-1, sinjalizimi horizontal dhe vertikal, tek para-masa dhe para-llogaria.⁵ Gjithashtu, për PSH ka qenë e papranueshme edhe kërkesa tjetër e AK tek Dosja e Tenderit, neni III.2, lidhur me kapacitetet teknike dhe profesionale që duhet të ofrojnë Operatorët Ekonomikë. Pas evidentimit të këtyre shkeljeve, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-vlerësim.


⁵ Këtu Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat ligjore të nenit 7 (Barazia në Trajtim/Jo Diskriminim), nenit 27 (Dosja e Tenderit) dhe nenit 28 (Specifikimet Teknike). Me gjerësisht shih Ligjin e Prokurimit Publik.

Raportimet e Gazetave në Fushën e Prokurimit Publik



Raportimet e gazetave ditore⁶ në fushën e prokurimit publik përbëjnë një rëndësi të jashtëzakonshme në eliminimin e parregullsive ligjore dhe praktikave korruptive në kuadër të kësaj fushe. Përgjatë periudhës tremujore gazetave ditore kanë publikuar gjithsej 69 artikuj të ndryshëm. Prej tyre 24 shkrime kanë qenë në gazetën Zëri; 22 në Koha Ditore, 15 sosh në gazetën Express dhe 8 shkrime në Kosova Sot.

Prej këtyre 69 artikujve gazetaresk 34 kanë qenë raportime hulumtuese, ndërkaj 35 sosh kanë qenë të publikuara në formën e lajmeve. Gazeta Zëri ka realizuar gjithsej 14 artikuj me natyrë hulumtuese dhe 10 shkrime tjera si lajme; Koha Ditore ka realizuar 12 raportime hulumtuese, kurse 10 lajme; Express 6 tema hulumtuese, ndërsa 9 lajme dhe Kosova Sot 6 lajme dhe 2 shkrime hulumtuese.



⁶ Në kuadër të hulumtimit tonë kemi zgjedhur vetëm katër gazetave kryesore ditore në Kosovë: Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe gazeta Express.

Rekomandimet:

1. Lëvizja FOL rekomandon që çmimet e ofruara për tenderë të ndryshëm të jenë jashtë dosjeve të tenderit - në mënyrë që të evitohet mundësia e keqpërdorimeve;
2. Lëvizja FOL rekomandon që Autoritet Kontraktuese të lejojnë qasjen e mbikëqyrjes së shoqërisë civile në procesin e prokurimit publik;
3. Lëvizja FOL i rekomandon OSHP-së dhe AK që të ndërmarrin masa ndëshkuese për zyrtarët e prokurimit që bëjnë shkelje të qëllimshme të dispozitave ligjore dhe atyre të rregulloreve;
4. Lëvizja FOL rekomandon që Autoritetet Kontraktues të raportojnë rastet në Prokurori kur Operatorët Ekonomikë provojnë të bëjnë falsifikim të dokumenteve dhe mashtrimeve të natyrave tjera;
5. Lëvizja FOL rekomandon që, përveç AÇP-së, Autoritetet Kontraktuese ta involvojnë edhe Komisionin i Konkurrencës - në rast të tenderëve jo-normalisht të ulët (që përmbajnë çmime që dëmtojnë konkurrencën);
6. FOL rekomandon që dosjet e tenderëve të thjeshtëzohen dhe hartimi i tyre të bëhet më me kujdes, në mënyrë që të shmangen format e ndryshme të diskimit dhe trajtimit jo të barabartë të ofertuesve, duke ndikuar në reduktimin e ankesave nga OE.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Instituti për Shoqëri të Hapur, Mbrojtësit e të Drejtave Civile dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë. Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.